

## THIRRJE PËR APLIKIM PËR NVMV-të NË KUADËR TË PROJEKTIT PËR DIGJITALIZIM OEK - ITP

Oda Ekonomike e Kosovës(OEK) në bashkëpunim me Parkun për Inovacion dhe Trajnim (ITP) Prizren kanë hyrë në partneritet që ka për qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat përmes transformimit digjital. Ky partneritet vjen si vazhdimësi e partneritetit strategjik me GIZ Kosova mbështetur nga Qeveria Gjermane në kuadër të projektit për Krijimin e Punësimit Përmes Promovimit të Eksportit.

Komponenti kryesor i këtij partneriteti në mes OEK dhe ITP **është krijimi i strategjive digjitale për NVM-të Kosovare**. Në kuadër të këtij partneriteti, OEK do të angazhojë Konsulentë Digjital të Certifikuar të specializuar në tre module për të ju shërbyer nevojave të kompanive duke ofruar për kompanitë:

1. Analizën e detajuar të ekspertëve
2. Zhvillimin e strategjisë digjitale

### Shërbimet e ofruara

NMVM-ve të përzgjedhura do t'u ofrohen këto shërbime:

- Analiza e ekspertëve (2 ditë angazhim dhe bashkëpunim në mes të konsulentit dhe kompanisë) – Në këtë fazë konsulenti digjital do të vizitoj kompaninë dhe vlerësoj situatën aktuale lidhur me nevojat e digjitalizimit dhe përdorimin e mjeteve digjitale. Konsulenti do të monitoroj nga afër kompaninë dhe do të intervistojë drejtorët apo punëtorët për të parë se cili departament ose proces ka nevojë për transformim dhe në cilën fushë nevojitet digjitalizimi.
- Zhvillimi i strategjisë digjitale (e përshtatur me nevojat specifike të kompanisë)

Të gjitha profilet e konsulentëve të cilet do bëjnë analizën e ekspertëve dhe zhvillimin e strategjive digjitale janë të përfshira në faqen e Qendrës për Transformim Digjital, përmes së cilës mund të merrni të gjitha informatat rreth projektit.

### Kush mund të aplikojë

Të gjitha NMVM-të e interesuara nga sektori i prodhimit, agrobiznesit apo shërbimeve mund të aplikojnë për ti përfituar këto shërbime përmes webfaqes të Qendrës për Transformim Digjital (në kuadër të OEK) [www.dtoek.org](http://www.dtoek.org) apo duke dërguar dokumentet e nevojshme në [dt@oek-kcc.org](mailto:dt@oek-kcc.org) deri më 27.06.2021.

## Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Certifikata e regjistrimit
- Formulari për aplikim
- Qarkullimi vjetor nga ATK për 2020, 2019\*
- Lista e të punësuarve\*
- Dokumente tjera relevante për eksport\*

*\*të rekomandueshme por opsionale*

Afati i fundit për aplikim është: 27.06.2021

## Kriteret e vlerësimit:

Kriteret	Vlerësimi (1 deri në 5)	Komentet
Madhësia e kompanisë dhe sektori ku operon		
Numri i të punësuarve		
Eksporti dhe konkurrueshmëria		
Rritja e punësimit, qarkullimit dhe ndërlidhja e këtyre indikatorëve me digjitalizim		
<b>Total</b>		

Kompanitë e përzgjedhura do të përfshihen në projektin e OEK – ITP sipas kohëzgjatjes së projektit duke ju mundësuar shërbimet e lartpërmendura. Kompania duhet të ndaj kohën për angazhim me konsulentin me qëllim të kryerjes së shërbimeve të ofruara.

## Ankesat

Secili aplikues ka të drejtë ankese të cilën mund ta drejtoj tek [dt@oek-kcc.org](mailto:dt@oek-kcc.org) brenda 5 dite pas pranimit të përgjigjes në lidhje me rezultatin e përzgjedhjes.

## Formulari për aplikim

NMVM-të e interesuara mund të aplikojnë duke plotësuar këtë formular për të përfituar shërbimet:

- Analiza e konsulentit digjital për kompani
- Zhvillimi i strategjisë digjitale të përshtatur me nevojat e kompanisë

**1. Emri i kompanisë:**

**2. Adresa/vendndodhja:**

**3. Pronar/Përfaqësuesi ligjor:**

**4. Sektori ku ndërmarrja operon/përshkrim i aktivitetit të ndërmarrjes:**

**5. Numri i të punësuarve:**

**6. Qarkullimi vjetor:**

Qarkullimi(euro)	Viti 2019	Viti 2020
5,000 – 25,000		
25,000 – 50,000		
50,000 – 100,000		
100,000 -300,000		
Tjetër (mbi 300,000)		

**7. A eksporton ndërmarrja dhe nëse po në cilat vende?**

**8. A mendoni se biznesit tuaj do t'i ndihmonte një analizë dhe strategji të detajuar e digjitalizimit?**

**9. Sa ka rëndësi digjitalizimi për ndërmarrjen tuaj dhe si e shihni ndikimin e tij në rritje të punësimit, qarkullimit dhe rritjes të konkurrueshmërisë?**

**10. Në cilat fusha të biznesit mendoni se është i nevojshëm transformimi digjital në kompaninë tuaj?**

**11. Nëse keni një strategji digjitale të përshtatur me nevojat e juaja, a keni gatishmëri ta implementoni atë?**

**12. Kompania pranon të bashkëpunoj me konsulentin digjital, të ndaj kohë dhe të caktoj një apo disa persona përgjegjës nga kompania për fazën e imlementimit të shërbimeve te ofruara?**

**Po    Jo**

**Dokumentet e bashkëngjitura bashkë me formularin për aplikim:**

- **Certifikata e regjistrimit**
- **Formulari për aplikim**
- **Qarkullimi vjetor nga ATK për 2020, 2019\***
- **Lista e të punësuarve\***
- **Dokumente tjera relevante për eksport\***

***\*të rekomandueshme por opsionale***

Afati i fundit për aplikim është: **2 .06.2021**. Të gjitha NMVM-të e interesuara nga sektori i prodhimit, agrobiznesit apo shërbimeve mund të aplikojnë për ti përfituar këto shërbime përmes webfaqes të Qendrës për Transformim Digjital (në kuadër të OEK) [www.dtoek.org](http://www.dtoek.org) apo duke dërguar dokumentet e nevojshme në [dt@oek-kcc.org](mailto:dt@oek-kcc.org)

**Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit te biznesit:**

**Data:**

**Nënshkrimi dhe vula(nëse plotësohet fizikisht):**